REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PUSTEC**
**SEKTORI I FINANCËS**

**Nr.255/1 Prot** **Pustec, më 19.02.2026**

**PROJEKT-VENDIM**
**NR 1 Datë 19.02.2026**

**MIRATIM FONDI PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË FITUAR NGA QARKU KORÇË**

Mbështetur në neni 8, pika 2, neni 9, pika 1,1.1, shkronja "a" dhe "b" , neni 24, pika 1, neni 55, pika 2 dhe 6, ligji nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetë qeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 ''Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne R.Shqiperise''i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.664 datë 24.10.2025, Për propozimin e projektligjit "Për buxhetin e vitit 2026", VKB nr.100 datë 24.12.2025 "Për miratimin e Planit të Buxhetit për vitin 2026" , Ligji nr.68 date 27.04.2017 ''Per financat e vetqeverisjes vendore' , si dhe bazë të projekt vendimit të përgatitur nga grupi i punës të sektorit të financës, VKB nr.12, datë 26.02.2026 "Për miratimin e të ardhurave të trashëguara nga viti 2025 për vitin 2026", dhe Planit të bashkëpunimit me Qarkun i propozojmë Këshillit të Bashkisë:

**TË MIRATOJ**

1. Mbështetjen financiare për blerjen e dy mjeteve për menaxhimin e Liqenit të Prespës dhe zhvillimin e turizmit lokal, përkatësisht:
   - Autokombanjë ujore për pastrimin e sipërfaqes së liqenit nga algat dhe mbeturinat;
   - Anije turistike lundruese me kapacitet 10-20 persona, e përdorur por në gjendje të mirë pune, për realizimin e tureve turistike dhe guidave në liqen.
2. Vlera totale e blerjes së dy mjeteve është 8,000,000 (tetë milion) lekë, prej të cilave:
   - 60% ose 4,800,000 lekë do të sigurohet nga Qarku si mbështetje financiare dhe logjistike;
   - 40% ose 3,200,000 lekë do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Pustec.
3. Bashkia Pustec, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e Qarkut, do të organizojë përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve, duke garantuar:
   - Mbrojtjen e ekosistemit të Liqenit të Prespës;
   - Sigurimin e kushteve të sigurta dhe të pastra për vizitorët;
   - Promovimin e turizmit lokal dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe turistike.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i projekteve dhe financës të cilët do të raportojë rregullisht për realizimin e projektit dhe shpenzimet e kryera.

**PËRGJEGJEËS I SEKTORIT TË FINANCËS**
**CVETKO NASTO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA PUSTEC

**KRYETARI I BASHKISË**
**PALI KOLEFSKI**

Adresa : Pustec, Korçë Tel. 0035586792012 e-mail : bashkia.pustec@gmail.com